REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:039159

Datë: 12.03.2021

Numri i dokumentit: 01589225

P.nr.113/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i përgjithshëm**,** Gjyqtarja Diana Sina**,** me sekretaren juridike Lamije Kuqi, në lëndën penale kundër të akuzuarit F. M. nga Malisheva, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, me numër PP.nr.1795/2017, të datës 16.03.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën **03.03.2021**, në prezencën e Prokurores të shtetit Dëshire Jusaj, të akuzuarit, të mbrojtësit të tij av.Agron Kryeziu, të dëmtuarit A. P., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt.12.03.2021 përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari **F. M.** i biri i M., i nënës H., e gjinisë B. Data e lindjes . . . në Malishevë, ku edhe tani banon në rrugën . . .. ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

Ë sh t ë f a j t o r:

Sepse: Me datën 10.06.2017 në kohë të pacaktuar, në Rr.”. . .” në Malishevë, me qëllim përfitimi të kundërligjshëm pasuror për vete apo personit tjetër ka shkuar në agjencinë “. . .” pronë e të dëmtuarit A. P. dhe pasi me parë ka përdorur forcën, ka thyer derën e zyrës, ka dëmtuar përbrenda dhe nga aty ka marr telefonin e tipit “. . ” – tip i thjesht në vlerë prej 28 euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 par.1 të KPRK-së,

Gjykata në bazë të nenit 4, 17 par.1,41,42,46,49,50,51,52,73,74, dhe nenit 327 par.1 të KPRK-ës, si dhe nenit 365 të KPPK-ës.

GJ Y K O N

DËNIM ME GJOBË, në shumë prej **100.-(njëqind)Euro**, të cilën dënim është i detyruar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si dhe

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1(një) viti**, I cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) vite**, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

2018:039160

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, Gjykata në bazë të nenit 46 par.3 të KPPK-ës, dënimi me gjobë do ta zëvendësoi me dënim burgu në kohëzgjatje prej **5(pesë) ditësh**, duke llogaritur çdo ditë të qëndrimit në burgim nga **20.-€.(njëzet) euro,** të gjobës.

Detyrohet I akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumë prej **30.oo Euro**, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej **30.oo(tridhjetë) euro**, e krejt këtë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari A. P. nga fshati . . . K.Malishevë, është tërhequr nga kërkesa për realizimin e kërkesës pasurore juridike, prandaj nuk udhëzohet që këtë kërkesë të realizon në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.1795/2017, të datës 16.03.2018, kundër të akuzuarit F. M. nga Malisheva, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë, nga neni 327 par.1 të KPRK-së, duke propozuar gjykatës që të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohet sipas Ligjit.

I akuzuari F. M. në shqyrtimin fillestar lidhur me fajësinë deklaron se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohem, ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës për të cilën vepër jam penduar pa masë, më vjen turp për një vepër të kryer por edhe vetë nuk e dij se si e kam kryer këtë vepër, tani në prezencë të gjykatës i kërkoi falje të dëmtuarit A. dhe i premtoi se në të ardhmen nuk do të përsërisë të njëjtën, shton se jam në gjendje të dobët materiale, si dhe më përpara nuk kam qenë i dënuar, tani kam filluar të punoi dhe të kontribuo në familje, andaj i propozoi gjykatës që të ketë parasysh këto rrethana dhe të më shqiptoi një dënim më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Agron Kryeziu deklaron, pas konsultimeve me të mbrojturin tim i njëjti e pranon veprën penale për të cilën akuzohet, i njëjti e ka pranuar në të gjitha fazat e zhvillimit të procedurës i në polici ashtu edhe në prokurori, me rastin e dhënies së deklaratës në polici i mbrojturi im e ka sqaruar rastin se ditën kur ka ndodhur vepra penale në vazhdimësi ka kryer veprën penale të vjedhjes me të njëjtin mjetë edhe në polici ka shprehur keqardhje për rastin që ka ndodhur duke potencuar se atë ditë nuk ka qenë vetvetja, në aspektin psikik, ku pas dhënies së deklaratës si mbrojtës kam kërkuar nga policia që të njëjtit ti bëhet ekzaminim psikiatrik, pasi që i njëjti ka qenë në gjendje shumë të rëndë psikike, i mbrojturi im gjithnjë sipas deklarimit të tij asnjëherë më parë nuk ka pasur vepra penale të natyrës së njëjtë apo edhe të natyrave tjera penale, duke marr për bazë të gjitha këto gjykatës i propozojmë që me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese të pranimit të fajësisë, deklarimin e të dëmtuarit që nuk i bashkëngjitët ndjekjes penale, shprehjes së keqardhje për rastin që ka ndodhur në mënyrë që me rastin e matjes së dënimit të jetë një dënim sa më i butë ose eventualisht një dënim të kushtëzuar që mendoi që do të arrihet efekti ndëshkues.

I dëmtuari A. P. deklaron se unë si palë e dëmtuar nuk i bashkëngjitëm ndjekjes penale dhe nuk kërkoi kompensimin e dëmit, telefoni mobil i vjedhur ka qenë i një vlere shumë të vogël.

Duke u deklaruar lidhur me mendimin lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit ka deklaruar se nuk e kundërshton pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë me vullnet dhe vetëdije të plotë dhe i njëjti ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të

2018:039160

fajësisë dhe se pranimi i fajësisë u bë në mënyrë të vullnetshme dhe se pranimi mbështet ne faktet dhe provat që përmban aktakuza.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetuar se i akuzuari F. M.: Me datën 10.06.2017 në kohë të pacaktuar, në Rr.”. . .” në Malishevë, me qëllim përfitimi të kundërligjshëm pasuror për vete apo personit tjetër ka shkuar në agjencinë “. . .” pronë e të dëmtuarit A. P. dhe pasi me parë ka përdorur forcën, ka thyer derën e zyrës, ka dëmtuar përbrenda dhe nga aty ka marr telefonin e tipit “. . ” – tip i thjesht në vlerë prej 28 euro.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtarja e vetme gjykuese konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: gjendjen e tij të dobët ekonomike, sjelljet korrekte në gjykatë, pranimin e fajësisë, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, kërkim falje të dëmtuarit, intensiteti i rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me këtë vepër ka shkaktuar dëm shumë të vogël të dëmtuarit, e sidomos faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar, në bazë të këtyre gjykata konstaton se ekzistojnë rrethanat posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë, konform nenit 75 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-së. Duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata të njëjtit i gjykoi me dënim te përshkruar si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, me bindje se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor, është marr komfor nenit 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 453 të KPPK-se, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 365 të KPP-së.

2018:039160

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.113/18 me datën 03.03.2021

Sekretarja juridike
Lamije Kuqi

Gjyqtarja e vetme gjykuese,
Diana Sina

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.

2018:039160